

PLANI PËR RIKTHIMIN E STAFIT NË PUNË DHE VIJUESHMËRIA NORMALE E ORAREVE NË PUNË TË SHOQËRISË ALBSIG JETË GJATË PERIUdhËS SË PANDEMISË TË SHKAKTUAR NGA COVID-19.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në vijim të **PLANIT TË VEPRIMIT PËR REDUKTIMIN E STAFIT DHE ORAREVE NË PUNË TË SHOQËRISË ALBSIG JETË GJATË PERIUdhËS SË PANDEMISË TË SHKAKTUAR NGA COVID-19** të shoqërisë ALBSIG JETË sh.a, kjo e fundit ndermerr masa për rikthimin e e stafit në pune dhe vijueshmërinë e orareve në punë të shoqërisë, si më poshtë:

1. Shoqëria ALBSIG JETË do të vazhdojë aktivitetin e saj për të ofruar shërbimin e nevojshëm ndaj klientëve.

2. Strukturat e ALBSIG JETË në qendër dhe degë do të funksionojnë me staf të plotë por duke marrë masat mbrojtëse të domosdoshme për ruajtjen e kolëgeve nga rreziku i përhapjes së pandemisë.

3. Punonjësit do të paraqiten në punë, por do të punojnë në zyrë të ndryshme të ALBSIG JETË sh.a duke ruajtur distancimin fizik prej 2 m.

4. Orari i punës do të jetë i plotë duke marrë parasysh të gjitha masat e nevojshme kundrejt COVID 19.

5. Në Drejtorinë Qendrore të ALBSIG JETË sh.a janë afishuar masat mbrojtëse për ruajtjen e distancës dhe dezinfektimin e çdo klienti apo punonjësi.

6. Pajtimi i një shoqërie profesionale për dezinfektimin periodik javor të ambienteve të zyrave qendrore të ALBSIG JETË.

7. Për cdo punonjes (si dhe pjesëtar të familjes) të ALBSIG JETË në Zyrën Qendrore të kryhet testi serologjik cdo 2-javë për arsye depistimi dhe mbajtje nën kontroll të situatës ndaj COVID-19.

8. Në rast evidentimi të cdo punonjësi të prekur nga COVID-19 (pas kryerjes së testit serologjik) ata udhëzohen të qëndrojnë në shtëpi duke marrë mjekin e rekomanduar nga mjeku specialist – në bashkëpunim me këshillat e dhëna nga mjeku i shoqërisë ALBSIG JETË sh.a.

9. Për të gjithë punonjësit e evidentuar sipas pikës (8) ALBSIG JETË sh.a. merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet spitalore dhe mjekësore.

10. Punonjësit e shoqërisë janë të detyruar të respektojnë aktet ligjore, normative, nënligjore dhe aktet e brendshme të shoqërisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë duke respektuar të gjitha masat e shpallura për këtë qëllim. Pa përjashtuar masat e tjera, çdo punonjës duhet të njoftojë nëse ekspozohet kundrejt rrezikut të infektimit nga COVID-19 ose ka simptoma të dyshuara për COVID-19 si Temperature mbi 38 gradë, kollë, ethe sidomos pneumoni dhe vështirësi në frymëmarrje.


11. Gjatë orarit të punës çdo punonjës duhet të respektojë distancën e sigurisë, të përdorë mjetet e vendosura në dispozicion nga shoqëria për dizinfektimin e duarve.

12. Punonjësit që do të kenë kontakt ndaj klientëve duhet:

- a. Të dezinfektojnë mjetet e punës me mjetet e dezinfektimit;
- b. Të mos lejojnë praninë e më shumë se një personi që i ofrohet shërbim;
- c. Të përdorin maska mbrojtëse dhe doreza si dhe mjetet e dezinfektimit;
- d. Të respektojnë distancën e kërkuar me klientin dhe në çdo rast jo më afër se 3 m;
- e. Të udhëzojnë klientët të qëndrojnë në distancë të largët nga njëri-tjetri dhe të eliminojnë çdo kontakt fizik me ta;
- f. Të trajtojnë me kujdes çdo dokument që marrin nga klientët për të mos u infektuar;
- g. Të vendosin njoftime të dukshme për respektimin e distancës së sigurisë nga klientët.
- h. Të zbatojnë instruksionet që vendosen e publikohen nga organet e ngarkuara për menaxhimin e pandemisë të shkaktuar nga COVID-19
- i. Të kryejnë testet serologjike periodikisht konform pikës 7 të këtij plani.

13. Mosrespektimi i këtyre kërkesave sjell përgjegjësi të rëndë disiplinore për çdo punonjës të Shoqërisë ALBSIG JETË.

14. Ky planveprimi zbatohet deri në përfundim të pandemisë dhe do të jetë objekt rishikimesh për t'u përshtatur me situatën e shkaktuar nga COVID-19.

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Spahy', with a large, sweeping flourish extending to the left and a long horizontal line underneath.